



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS SPANJOLLE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore seminar

Viti /Semestri: Viti I, semestri II

Lloji i lëndës : Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Hispanik

Kodi i etikës : Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Objektivi kryesor i kursit është që studenti të jetë i aftë të ndërveprojë përmes kompetencës komunikative që ofron Niveli A2, i përshkruar në MCERL (Manuali i referencës).

Objektivat specifike lëndore:

1. Të jetë i aftë të përshëndesë dhe të prezantohet në spanjisht
2. Të numërojë, të dallojë gjininë e emrave dhe të përdorë nyjet e tyre
3. Të flasë për profesionet dhe të përshkruajë shkurt klasën apo shtëpinë e tij
4. Të zgjedhë foljet e kohës së tashme, mënyra dëftore
5. Të krijojë një fjalor bazik për komunikim të thjeshtë në spanjisht

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do të kenë konsoliduar aftësitë e tyre të folurit, shkruarit dhe komunikuarit në gjuhën spanjolle.